

E ENJTJA E MADHE

MBREMESORJA DHE MESA E SHEN BASILIT

Kjo Shërbesë bëhet të Enjten e Madhe në mëngjes. Këndimet vazhdojnë sipas Uratores, f. 1-13, gjer në Thirrtoret:

THIRRTORET, T. II.

PAS IKOS TU EFRATHA.

Këndohen gjashtë, dyke përsëritur të parën, me Vargjet e radhitura në fundin e Psalmët të Thirrtoreve më sipër:

Mblidhen Judenjët sot, ta vrasin Krijetarin, mejtohen si ta zënë, ta shpien tek Pillati, për kryqësim dhe për varrim. (2 herë)

Juda bukën e merr, në darkën e bekuar, dhe dorën e paudhë, e zgjati për argjëndet, Mësonjësin e tradhëton.

Juda puthje i jep, e shiti për argjënde, në duart' ua shtie, ta therin si një shqerrë, të vetëmin mëshirëplot.

Juda si faqezi, dinak dhe i pabesë, lakmonte për fitime, pa turp e shiti Krishtin, këtej e puth andej e vret.

Shqerr' e Profetëve, për therje sot po sillet, e rrahin e pështyjnë, me çpifje e dënojnë, Jesunë Perëndi dhe Zot.

LAVDI DHE TANI, T. T. II.

Juda ishte me të vërtetë, këlysh i atyre nëpërkave, që hëngërnë mannën në shkretëtirë, dhe prapë grindëshin kundër ushqenjësit; se me të ngrënë në gojë, flisnin kundër Perëndisë mosmirënjohësit; edhe ky me Bukën qjellore në gojë, vepëroj tradhësinë! E shiti ushqenjësin, dhe e tradhëtoj Zotin me puthje. Me të vërtetë ishte bir i tyre i paudhi, dhe tok me ata humbi për jetë. Nga kjo çnjerëzi shpëtoji shpirtet tona, o Zot i zëmërgjerë dhe i zëmërdhëmpshur.

Pastaj bëhet Hyrja e Vogël me Ungjillin: Dhjaku përpara dhe Prifti pas, dalin nga dera e veriut, qëndrojnë përpara Derës së Bukur, dhe Prifti bekon Hyrjen. Pastaj Dhjaku ia jep Priftit Ungjillin që ta përshëndoshë, shkon përpara Priftit, edhe thotë me zë të lartë:

DHJAKU: Urtësi, o të drejtë.

Prifti dhe Dhjaku hyjnë brënda në Shenjtëroren, dhe Dhjaku temjanis Alltarin; Kori këndon:

KORI: Dritë gazmore e lavdisë qjellore, Jesu Krisht, si arrimë perëndimin e diellit, edhe pamë dritën e mbrëmës, hymnojmë Atin e Birin edhe Shpirtin Shenjt, se të ka hie kënga kurdoherë, o i Bir i Perëndisë që fal jetën, përandaj të lavdëron e tërë bota.

Pas Këndimeve prej Dhatës së Vjetër, Dhjaku thotë Litanië e Vogël:

DHJAKU: Përsëri dhe përsëri, më paqe le t'i lutemi Zotit.

KORI: Mëshiro, o Zot.

DHJAKU: Përkrahna, shpëtona, mëshirona, dhe ruajna, o Perëndi, me hirin tënt.

KORI: Mëshiro, o Zot.

DHJAKU: Tërëshenjtën, të pacinuarën, të përmi-bekuarën, të lavdëruarën, Kryezonjën tonë Hyjlindësen dhe gjithënjë Virgjëreshën Mari, dyke kujtuar me gjithë Shenjtorët, veten tonë dhe njerjatrën dhe tërë jetën tonë, Krishtit Perëndi le tja pranojmë.

PRIFTI: Se i shenjtë je, o Perëndia ynë, dhe ty të dërgojmë lavdi, Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani dhe përherë.

DHJAKU. Dhe në jetët e jetëve.

KORI: Amin. Shenjt Perëndi, Shenjt i fuqishim, Shenjt i pavdekur, mëshirona. (3 herë)

KORI: Lavdi Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani dhe përherë, dhe në jetët e jetëve. Amin. Shenjt i pavdekur, mëshirona.

DHJAKU: Fuqi.

KORI: Shenjt Perëndi, Shenjt i fuqishim, Shenjt i pavdekur, mëshirona.

Në këtë mes, Prifti me zë të unjur thotë Uratën e Hymnit Trishenjtor nga Mesha e Shën Basilit, e cila nis që këtë pikë, dhe vazhdon gjer në funt. Passi mbarohet Hymni Trishenjtor, Dhjaku del përpara Derës së Bukur, dhe thotë me zë të lartë:

DHJAKU: Le të vemë re.

Pastaj këndohet:

APOSTULLI

Krerët u-mblohnë për këshillë.

Përse çfryjtin paganet edhe popujtë?

Këndimi prej Letrës së Parë së Palit për Korinthianët.

Vëllezër, unë e mora prej Zotit atë, që ju dorëzova që Zoti Jesu, atë natë që u-tradhëtua, mori bukë, përhiroj, e theu, dhe tha: "Merrni, hani, ky është trupi im që thyhet për ju; bëjeni këtë për kujtimin tim." Gjithashtu e mori edhe kupën pas darkës, edhe tha: "Kjo kupë është dhjata e re me gjakun tim; bëjeni këtë për kujtimin tim kurdoherë që pini." Se kurdoherë që e hani këtë bukë, dhe e pini këtë kupë, e çpallni vdekjen e Zotit gjer sa të vinjë përsëri. Përandaj, ay, që e ha këtë bukë, dhe e pi kupën e Zotit pavyerisht, do të jetë fajtor i trupit edhe i gjakut të Zotit. Pra, le ta shprovonjë veten njeriu, dhe pastaj le të hanjë nga kjo bukë, dhe le të pinjë nga kjo kupë. Se ay, që e ha dhe e pi pavyerisht, ha dhe pi një dënim për veten, se nuk e nderon trupin e Zotit. Nga ky shkak, ka midis jush shumë të pafuqishmë dhe të sëmurë dhe të fjetur. Se po ta

gjykonim veten, nukë do të dënohëshim. Po kur gjykojmë veten, arësohemi prej Zotit, që të mos dënohemi bashkë me botën.

UNGJILLI PAS MATTHEUT

Zoti u tha Dishepujve: “E dini se pas dy ditësh kemi Pashkën, edhe i Biri i njeriut tradhëtohet për të kryqësuar. Ahere Kryepriftinjtë dhe pleqtë e popullit u-mblojnë në hoborrin e Kryepriftit, i cili quhej Kajafa, dhe u-mejtuan ta zinin Jesunë me dinakëri dhe ta vrisnin. Edhe thoshin: “Të mos e zemë ditën e kremte, që të mos bëhet nonjë trazirë midis popullit.” Dhe kur ishte Jesuj në Bethani, në shtëpinë e Simon Leprozit, i ardhi një grua me një allabastër prej myrre shumë të shtrenjtë, dhe ia derdhi mi kokë, kur ishte shtruar në mësallën. Dhe kur e panë, dishepujtë u-zëmëruan, dhe thanë. “Përse kjo humbje? Se kjo myrrë munt të shitej për një sumë të lartë, e cila t’u përndahej të varfërve.” Dhe Jesuj, kur e mori vesh, u tha: “Përse e mërzitni gruan? Se ajo më bëri një shërbim të mirë. Se të varfërit i kini kurdoherë me vete, po mua nuke më kini gjithënjë. Pastaj ajo ma derdhi myrrën mi trupin për varrimin tim. Me të vërtetë po ju them, kudo në botë që do të lëçitet ky Ungjill, do të kujtohet edhe vepra e kësaj gruaje. Ahere një prej të dymbëdhjetëve, i cili quhej Juda Iskarioti, u vajti Kryepriftinjtë, dhe u tha: “Ç’ më jipni, që t’jua dorëzonj?” Edhe ata i dhanë tridhjetë argjende. Dhe që ahere kërkonte rast që ta tradhëtonte.

Edhe ditën e parë të Ndormeve dishepujtë i arthnë Jesujt, edhe i thanë: “Ku ta gatitim darkën e Pashkës?” Edhe ay u tha. “Shkoni në qytetin tek aksh njeri, edhe i thoni: ‘Mësonjësi thotë: Koha ime u-afrua; do ta

bënj Pashkën me dishepujtë në shtëpinë tënde.’” Edhe dishepujtë bënë ashtu, sikundër i porrositi Jesuj; edhe atje e gatitën Pashkën. Edhe Jesuj, dyke ditur që Ati ia kishte dhënë të gjitha në dorë, dhe që kishte ardhur nga Perëndia, dhe që do të kthehej tek Perëndia, u-ngrit nga darka, dhe i çveshi robot; edhe mori një peshqir, edhe e ngjeshi në mest; pastaj hodhi ujë në legjenin, edhe nisi tua lante këmbet dishepujve, dhe tua fshinte me peshqirin, me të cilin ishte ngjeshur. Pastaj i vajti Simon Pjetrit, edhe ky i tha: “Zot, ti po m’i lan këmbët?” Jesuj u-përgjeq, edhe i tha: “Atë, që po bënj unë, ti nuk e merr vesh tani, po do ta kupëtosh pastaj.” Po Pjetri i tha: “Kurrë nukë duhet të m’i lash këmbët.” Edhe Jesuj u-përgjeq. “Në mos t’i lafsha këmbët, ahere nukë ke asnjë lidhje me mua.” Edhe Simon Pjetri i tha: “Ahere, o Zot, m’i laj jo vetëm këmbët, po edhe duartë dhe kokën.” Edhe Jesuj i tha: “I lari nukë ka nevojë veçse t’i lanjë këmbët, edhe është i paqme i tëri; edhe ju jini të paqme, po jo të gjithë.” Se e dinte se një prej atyre do ta tradhëtonte; përëndaj, pra, tha: “Nukë jini të paqme të gjithë.” Edhe pasi ua lau këmbët, i veshi robot, u-shtrua në sofër përsëri, dhe u tha: “A e kupëtuat seç’ bëra? Ju po më quani Mësonjësi edhe Zot; edhe këtë e thoni mirë, se ashtu jam. Pra, posa unë, Zoti dhe Mësonjësi, jua lava këmbët, edhe ju detyroni tua lani këmbët njënjatrit. Se ju dhashë një shëmbëll, që të bëni edhe ju ashtu, sikundër ju kam bërë unë. Me të vërtetë, me të vërtetë po ju them që s’ka shërbëtor më të math se i zoti, as apostull më të math se ay, që e ka dërguar. Pra, tani, që i dini këto gjëra do të jini të lumur sikur t’i bëni.”

Edhe kur nisë të hanin, u tha: “Me të vërtetë po ju them se një prej jush do më tradhëtonjë.” Edhe ata

u-hidhëruan shumë, dhe cilido prej atyre e pyeste: “Mos jam unë, o Zot?” Edhe ay u-përgjehq, edhe u tha: “Ay, që ngjyen kafshoren në pjatën time, ay më tradhëton.” Edhe i Biri i njeriut bën ashtu, sikundër është shkruar për atë; po mjerë ay, i cili e tradhëton të Birin e njeriut! Do të ishte më mirë për atë, sikur të mos ishte lindur fare.” Edhe Juda, i cili e tradhëtoj, e pyeti: “Mos jam unë, o Rabbi?” Edhe Jesuj iu-përgjehq: “Ti vetë e thua.”

Edhe tek po hanin, Jesuj mori bukë, dhe e bekoj, dhe e theu, dhe ua dha dishepujve, dhe u tha: “Merrni, hani, ky është trupi im.” Pastaj e mori kupën, dhe përhiroj, dhe ua dha, edhe u tha: “Pini prej këti të gjithë, se ky është gjaku im i dhjatës së re, që derdhet për shumë për ndjesën e mëkatave. Edhe ja ku ju them, se që këtu e tutje nuke do të pi verë gjer sa të dalë vera e re në Mbretërinë e tim-Ati.” Edhe passi kënduan një hymn, duallnë dhe vajtin në Malin e Ullinjve.

Ahere Jesuj u tha: “Që të gjithë do të skandalizoheni për këtë natë; se është shkruar, ‘Do ta goditë barinë, dhe do të përndahen dhëntë e grigjës.’ Po passi të ngjallet, do të shkonj përpara, dhe do tju shoh në Galile.” Edhe Pjetri u-përgjehq, edhe i tha: “Edhe sikur të skandalizohen të gjithë, unë nukë do skandalizohem kurrë.” Edhe Jesuj i tha: “Me të vërtetë po të them se këtë natë, përpara se të thërresë këndesi, do më mohosh tri herë.” Edhe Pjetri i tha: “Edhe sikur të vdes me ty, prapë nukë do të mohoj.”

Ahere Jesuj shkoj me ata në një katunt, i cili quhet Gjethsemane, edhe u tha dishepujve: “Rrini këtu gjer sa të vete dhe të falem atje tutje.” Edhe mori

Pjetrin dhe të dy të bijtë e Zebedeut, edhe nisi të hidhërohej edhe të pikëlluhej. Edhe u tha: “Shpirti më është hidhëruar gjer në vdekje. Rrini këtu, dhe vigjëlloni me mua.” Edhe vajti pak më tutje, dhe u-përmbys mi faqen, edhe falej, edhe thoshte: “Ati im, në qoftë e mundur, le të shkonjë prej meje kjo kupë; me gjithë këtë, jo si dua unë, po si do ti.” Edhe iu-duk një Engjëll prej qjellit, i cili i jipte fuqi. Edhe e zuri agonia, edhe falej më nxehtë, dhe djersa i derdhej përdhe si pika të mëdha prej gjaku. Edhe passi u-ngrit, u-kthye, dhe i gjeti dishepujtë të fjetur, dhe i tha Pjetrit: “Qysh? Nukë muntë të vigjëlloni një orë me mua?” Vigjëlloni dhe faluni, që të mos hyni në ngasje; se shpirti është gati, po trupi është i pafuqishmë.” Pastaj shkoj për së dyti, dhe u-fal, edhe tha: “Ati im, nëqoftëse nuk është e mundur të shkonjë prej meje kjo kupë, edhe duhet ta pi doemos, ahere u-bëftë dëshira jote.” Edhe ardhi, dhe i gjeti përsëri të fjetur; se sytë u ishin rënduar. Edhe i la, dhe shkoj prapë, dhe u-fal për së treti, dhe tha gjithato fjalë. Pastaj u vajti dishepujve, dhe u tha: “Flini tani, dhe prëhuni; ja u-afua ora, dhe i Biri i njeriut tradhëtohet në duartë e mëkatarëve. Ngrëhuni, le të shkojmë; se ja, ku u-afua ay, që më tradhëton.”

Edhe tek po fliste edhe, ja ku ardhi Juda një prej të dymbëdhjetëve, me një turmë të madhe, me shpata dhe me drurë, nga ana e Kryepriftinjve dhe pleqve të popullit. Edhe ay, që e tradhëtoj, u dha një shenjë, dyke thënë: “Ay, që do të puth, ay është, zereni.” Dhe menjëherë i vajti Jesujt, edhe i tha: “Gëzohu, Rabbi,” edhe e puthi. Edhe Jesuj i tha: “Mik, përse ke ardhur?” Pastaj ata iu-afuan, vunë dorë mi Jesunë,

dhe e zunë. Dhe ja, një prej atyre, që ishin me Jesunë, e zgjati dorën, dhe e çveshi shpatën, dhe e goditi shërbëtorin e Kryepriftit, edhe ia preu veshin. Ahere Jesuj i tha: “Ver-e prapë shpatën në vëndin e saj; se të gjithë ata, që marrin shpatën, do të humbasin me shpatën. Apo kujton se nukë munt t’i lutem tim-Ati, dhe të më dërgonjë më tepër se dymbëhjetë legjione prej Engjëjsh? Po ahere si do të mbushen Shkripturat, të cilat e tregojnë se si duhet të bëhen?” Edhe gjithatë orë, Jesuj i tha gjindjes: “Kini dalë me shpata dhe me drurë që të më zini si nonjë kusar; unë rrinja për ditë me ju në tempull, dhe ju mësonja, dhe nukë më zutë. Po të gjitha këto u-bënë që të mbushen Shkripturat e Profetëve.” Edhe të gjithë dishepujtë e lanë dhe iknë.

Edhe ata, si e zunë Jesunë, e shpunë në shtëpinë e Kryepriftit Kajafa, ku ishin mbledhur Shkronjësit edhe pleqtë. Edhe Pjetri i vajti pas për së largu gjer në hoborin e Kryepriftit; edhe hyri brënda, edhe rrinte me shërbëtorët që ta shikonte fundin. Edhe Kryepriftinjtë, dhe pleqtë, dhe këshilla e tërë kërkonin dëshmin të rremë kundër Jesujt, që ta vrisnin, po mukë gjenin dot. Edhe ndonëse kishin ardhur shumë dëshmorë të rremë, prapë nukë gjenin njeri. Më në funt, arthnë dy dëshmorë të rremë, dhe thanë: “Ky njeri tha: ‘Munt ta prish tempullin e Perëndisë, dhe ta ndërtonj prapë në tri ditë.’” Dhe Kryeprifti u-ngrit, edhe i tha: “Nukë përgjigjesh gjësendi? Ç’thua për këto kallëzime që bëhen kundër teje?” Po Jesuj heshti. Pastaj Kryeprifti e pyeti prapë: “Të vë më be për Perëndinë e gjallë, thuajna

a je ti Krishti, i Biri i Përëndisë?” Edhe Jesuj iu-pergjeq: “Ti vetë e thua; po ja ku ju them se për së shpejti do ta shikoni të Birin e njeriut të rrinjë më të djathtën e Perëndisë, dhe të zbresë mi retë e qjellit.” Ahere Kryeprifti i çori robot, edhe tha që. “Blasfemoj. Ç’nevojë kemi më për dëshmorë? Ja, tani e degjuat blasfeminë e tij me veshët tuaj. Ç’thoni tani?” Edhe ata u-përgjeqnë dhe thane: Eshtë fajtor për vdekje.” Ahere e pështynë në faqe, edhe i ranë me grushte; disa të tjerë e goditnin me shuplaka, dhe e pyesnin: “Profetësona, o Krisht, kush të goditi?”

Edhe Pjetri rrinte jashtë në hoborr; dhe një shërbëtorë i ardhi, dhe i tha: “Edhe ti ishe me Jesu Galileasin.” Po ay e mohoj përpara të gjithëve, dhe tha: “Nukë kupëtonj se ç’ më thua.” Edhe dolli në derë të hoborrit, po atje e pa një tjetër, dhe u tha atyre rrotull: “Edhe ky ishte me Jesu Nazareasin.” Po Pjetri e mohoj prapë me be: “Nuk e njoh atë njeri.” Pastaj i arthnë ata, që ishin rrotull, dhe i thanë Pjetrit: “Me të vërtetë, edhe ti je një prej atyre; se folja jote të dëften.” Ahere nisi të nëmte, dhe bënte be që: “Nuk e njoh atë njeri asfare.” Dhe menjëhere thirri këndesi. Edhe Pjetri kujtoj fjalën e Jesujt, që i kishte thënë se: “Përpara se të thërresë këndesi, do më mohosh tri herë.” Dhe dolli jashtë, dhe qau hidhur.

Dhe kur u-gëdhi, të gjithë Kryepriftinjtë dhe pleqtë e popullit u-mejtuan që ta vrisnin Jesunë. Dhe passi e lithnë, e shpunë dhe ia dorëzuan guvernorit Pont Pillatit.

Pastaj vazhdon Mesha e Shën Basilit. Në vënt të Hymnit Kerubik, të Kungatores, dhe të “Pamë Dritën,” këndohet:

TROPARI I KUNGATES, T. T. II.

Në darkën tënde o Jesu, o i vetëmlindur Bir. merr-më sot pjesëtar në qjell, se askurr' armiqve, s' ua çfaq misterin, dhe puthje të pabesë, s' të jap si Juda kurrë, se ja si Kusari të thërres: Kujto-m' o Zot o Perëndi, kur të vish në mbretërine tënde.